



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 13, datë 04/02 /2020

MBI

“MIRATIMIN E PËR HAPJES TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË BACHELOR “FOTOGRAFI”, TË PARAQITUR NGA DEPARTAMENTI I ARTEVE TË APLIKUARA PRANË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 73 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të MASR nr. 1, datë 14/01/2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë”, VKM nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, (i ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18/12/2019), pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga F.A.B., pasi i diskutoi, me votim të hapur unanimitisht,

V E N D O S I:

1. Miratimin paraprak të dokumentacionit për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë Bachelor **“Fotografi”**, të paraqitur nga Departamenti i Arteve të Aplikuara pranë Fakultetit të Arteve të Bukura, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim ti dërgohet për miratim paraprak Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve dhe më pas të përcillet në MASR për miratim përfundimtar, sipas Pikës 4, Kreut VI të Udhëzimit nr. 1, datë 14/01/2020 nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë të Arteve të Aplikuara.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



